



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 74 Prot.

Tiranë, më 09.01.2025

V E N D I M

Nr. 14, Datë 09.01.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 258 Regj., datë 24.12.2024, të shtetases O. D, kundër Fakultetit të Shkencave Sociale (FSHS), pranë Universitetit të Tiranës dhe stafit të punonjësve/pedagogë¹ të Departamentit të Psikologjisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, O. D, evidentohet problematika e lindur mes saj dhe subjekteve kundrejt të cilëve ka pretenduar se e kanë diskriminuar.

Nisur nga kronologjia e ngjarjeve e rrethanave të shpjeguara, ankuesja, shprehet, ndër të tjera, se: *“Aplikimi im për të qenë studente në degën “Psikologji Organizacionale” është kryer përgjatë muajit shtator-tetor 2024, ku pasi kam dorëzuar të gjitha dokumentat e kërkuara për aplikim, jam*

¹ Znj. M. B, znj. E. D, znj. A. Sh dhe z. E. L.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

shpallur e 7 (shtata) në listën fituese dhe jam regjistruar më pas pranë sekretarisë mësimore përkatëse, të Departamentit të Psikologjisë. Prej 9 javësh kam qenë prezente rregullisht në leksionet e seminarit e degës ku studioj, duke plotësuar detyrimet e detyrave të kursit dhe provimeve të zhvilluara deri më tani.

Megjithatë, në këto 9 javë, Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS) ka patur një problematikë në lidhje me mua si studente, duke paraqitur disa arsye konfuze si:

- Nuk mund të marr numër matrikullimi nga qsha;
- Duhet të bëj dorëheqje të vullnetshme duke firmosur çrregjistrimin tim;
- Është shkelje e Fakultetit që unë të vazhdoj studimet dhe të shkoj në mësim.

Përgjatë kësaj periudhe konfuzuese dhe stresuese për mua, kam dërguar ankesa dhe kërkesa për ndërhyrje pranë FSHS, dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës.

Ankesat e mia i janë drejtuar Dekanit dhe Përgjegjëses së Departamentit të Psikologjisë, në raport me njoftimet telefonike nga sekretarja, për paraqitje urgjente në Fakultet, pasi sipas tyre nuk mund të vazhdoja studimet. Për sa i përket këtyre ankesave, kanë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe në raport me këto ankesa, unë akoma nuk as sot e kësaj dite ndonjë reagim nga Dekani i Fakultetit.

Kam nisur ankesë drejtuar Rektoratit të UT-së, në lidhje me problematikën që m'u paraqit si urgjente dhe pa rrugëdalje. Nuk kam ende një përgjigje zyrtare nga Rektorati për ankesën time, pavarësisht tejkallimit të çdo afati ligjor për përgjigje.

Më është ofruar një takim me Komisionin Vlerësues dhe zv/Dekanen, znj. Sh, të cilin e pranova dhe pas 5 javësh mësim, më është komunikuar që QSHA, ndoshta nuk më jep dot numër matrikullimi dhe ndoshta studimet e mia nuk do të rezultojnë me një diplomë në fund, duke më thënë se nuk plotësoj kriteret e degës. Gjatë takimit më është bërë presion që unë të çrregjistrohem dhe të largohem një një degë tjetër studimesh, duke më ofruar zgjidhje, të cilat nuk janë zgjedhjet e mia, me qëllimin e qartë që dhe unë, si një student tjetër që ra pre e veprimeve intimiduese, të nënshkruaj një dorëheqje të vullnetshme nga lista e fituesve. Ndryshe nga ky student, unë kam vazhduar të ndjek studimet dhe të dorëzoj detyrat e kursit rregullisht, duke përmbushur plotësisht detyrimet e mia si studente...”

Subjekti ankues ka shkëmbyer një sërë e-mailesh dhe ka paraqitur disa kërkesa/ankesa drejtuar Dekanit të Fakultetit, Rektoratit të UT-së, për të cilat shprehet se nuk ka marrë asnjë përgjigje megjithë tejkallimin e fateve ligjore.

Po ashtu, nëpërmjet e-maileve të këmbyerë me pedagogen e lëndës “Metoda Kërkimore”, znj. D, ankuesja është vënë në dijeni prej kësaj të fundit, se ajo nuk figuron në listën e studentëve të “Psikologjisë Organizacionale”, dhe për këtë arsye nuk mund të pranonte të merrte detyrën e kursit prej saj.

Ankuesja shprehet se, më datë 19 dhjetor 2024, pedagogia, znj. D ka refuzuar të marrë detyrën dhe nuk ka lejuar që ajo ta prezantojë atë, duke informuar se nga mosprezantimi i kësaj detyre, ajo humbet dhe të drejtën për t'u futur në provimin sezonal të kësaj lënde.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, që: *“Të ndërhyjë urgjentisht në mënyrë që të vijoj studimet normalisht, si dhe të mbroj detyrën e kursit që nuk m'u lejua të prezantoj, ashtu si çdo student tjetër fitues në degën master në “Psikologji Organizacionale”, pranë FSHS-së.”*

Pas pranimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues si dhe lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej saj kundrejt subjekteve të paditura.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 26.12.2024, nga ana e inspektorit të çështjes është proceduar me kërkesën për plotësimin³ e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj.

Nëpërmjet e-mailit datë 26.12.2024, ankuesja ka informuar se: *“Bashkëngjitur gjendet dokumentacioni i kërkuar:*

1- Diplome Bachelor

2- Kartë Studenti

3- Lista e fituesve

Ju informoj se dy ditë pasi unë e kam ngritur ankesën time në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Kontrollin e Kartë të Shtetit, ku për dijeni janë Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, më datë 24 Dhjetor 2024, jam telefonuar një punonjëse e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, e cila më ka kërkuar që të paraqitem në Rektorat për të tërhequr përgjigjen ndaj kërkesës time në Rektorat.

-
- Nje dokument apo akt tj provues, te regjistrimit tuaj prane FSHS, si studente ne degen Master Shkencor "Psikologji Organizacionale", per vitin 2024-2026;
 - Nese dispononi, aktin e çregjistrimit tuaj nga Masteri, nga ana e Institucionit ne fjale, (kopje te tij). Nese jo, shpjegimet tuaja per kete pretendim;
 - Kopje te diplomes tuaj Bachelor;
 - Informacion nese ne dijenine tuaj, ne degen qe ju ndiqnit (Master Shkencor "Psikologji Organizacionale"), ka studente te tjere te regjistruar, te cilet sikurse ju, nuk kane perfunduar studimet bachelor "Psikologji"; Nese po, ju lutem, te citoni specifikisht te dhenat per secilin student, nese dispononi. Nese jo, thjesht jepni sqarimet tuaja perkatese
 - Si dhe, informacion nese kete ceshtje po e ndiqni dhe gjyqesisht. Nese po, kopje te kerkese padise.

Kur jam paraqitur në Rektorat, kam kërkuar informacion se përse nuk më është përcjellur informacion në mënyrë institucionale dhe në kohë, dhe punonjësi i protokollit të Rektoratit ka pretenduar se ka kryer disa telefonata të mëparshme, me numrin e tij personal, çka është e pavërtetë dhe unë nuk kam marrë asnjë thirrje, pasi sipas tij telefoni i zyrës së Rektoratit nuk punon.

Për këtë situatë, mund të themi që unë si studente arrij të dërgoj 9 shkesa drejtuar 2 institucioneve, ndërkohë Universiteti më i madh në vend, i mbështetur me fonde dhe administratë me qindra vetë, nuk më njofton dot në kohë dhe në mënyrë korrekte, duke më gënjyer. Referuar përdorimit të emailit, punonjësi i Protokollit mu përgjigj se nuk do më jepte mua informacion se si mund të informojë studentët.

Së pari, nuk ka vendim, por një relacion pa numër protokollit që përban fakte të pavërteta referuar informimit apo përpjekjes së Fakultetit të Shkencave Sociale për zgjidhur gabimet, apo siç i quajnë ata vetë: “lapsuset” e tyre. Informimi ndaj problematikës është bërë pas 4 javëve mësim nëpërmjet një telefonate “urgjente” dhe aspak pas 10 ditësh mësim.

Së dyti, në shkresa përmendet vetëm një nga kërkesat e mia për ndërhyrje, të tjerat janë injoruar dhe ende pa asnjë përgjigje.

Së treti, data e protokollimit e ankesës time në Rektorat “Nr. 3398/1 Prot datë 25.11.2024”, nuk përputhet me datën që referon i gjithë stafi i Fakultetit të Shkencave Sociale “20.11.2024”, për ankesën me numër 3398/1 prot. Një “lapsus” tjetër i profesionsitëve që mbajnë tituj Prof. Asoc apo Prof.Dr. në Fakultetin e Shkencave Sociale, por me qëllimin e qartë për t’u futur brenda kohëzgjatjes së informimit institucional, veçanërisht pasi unë jam ankuar për këtë çështje në institucionet e lartpërmendura (Ministri e Arsimit dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit).

...

Referuar pyetjes tuaj, nëse ka student të tjerë, brenda konfidencialitetit, ju informoj se ka qenë dhe një student tjetër me emrin O. M që ashtu si unë, ju komunikua që në rast se nuk nënshkruan dorëheqje do të ngelej pa shkollë. Studenti në fjalë, i ka mbaruar studimet Bachelor në Gazetari, dhe nuk është më në Fakultetin e Shkencave Sociale, pasi dha dorëheqjen në mënyrë të vullnetshme pas lajmërimit të beftë që nuk mund të vazhdonte më studimet aty.”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion, rezulton se, ankuesja zotëron diplomë bachelor në “Punë Sociale⁴”.

⁴ Referuar diplomës me nr. 1114, datë 25.01.2021, lëshuar nga FSHS/UT.

Në muajin shtator 2024, në faqen e FSHS, pranë Universitetit të Tiranës, janë shpallur kriteret për studentët aplikantë për master shkencor në programin “Master Shkencor në Psikologji Organizacionale”.

Pasi është njohur me shpalljen e mësipërme, ankuesja ka aplikuar për ndjekjen e këtij masteri duke dorëzuar dokumentacionin përkatës dhe, në renditjen e studentëve aplikantë për fazën e parë në këtë program, është shpallur e 7 (shtata) në listën fituese. Në këto kushte, ankuesja shprehet se më pas është regjistruar pranë sekretarisë mësimore përkatëse të Departamentit të Psikologjisë.

Ankuesja, me datë 13.11.2024, është telefonuar nga një punonjëse e Sekretarisë së Departamentit të Psikologjisë dhe është vënë në dijeni të faktit se diploma e saj e bachelorit nuk përputhet me degën e masterit, sepse për ndjekjen e tij duhet që të kisha mbaruar master në “Psikologji”. *(Duke cituar e-mailin e ankueses dërguar Dekanit të Fakultetit, z. L, me datë 13.11.2024, ku ndër të tjera shprehet se: “...Përderisa unë i kam dorëzuar në rregull dokumentat, kam plotësuar formularin, jam regjistruar në Universitet, pasi dola e 7 (shtata) në listën e fituesve, nuk kam arsye se përse në javën e katërt pasi fillon mësimi të marr një telefonatë ku të më thuhet të vij urgjentisht në Fakultet dhe të flas me Kryesekretaren, ku çdo procedurë ishte kryer në rregull deri më tani...”)*

Ankuesja i është drejtuar disa subjekteve, si: Dekanit të FSHS, Rektorit të UT-së, Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, etj, nëpërmjet e-maileve dhe shkresave, duke i informuar lidhur me problematikën e hasur prej saj, si dhe duke kërkuar ndërhyrjen e tyre për ta zgjidhur atë.

Subjekti ankues shprehet se nuk ka marrë përgjigje për ankesat e saj, apo dhe kur e ka marrë ka qenë në tejkallim të afateve ligjore. Në këtë kontekst, është depozituar prej saj, përgjigjja e Komisionit (qe ka bërë dhe renditjen e kualifikimin e studentëve aplikantë për programin: Master Shkencor “Psikologji Organizacionale”), e cila daton më 02.12.2024, dhe shprehet si më poshtë: *“Bazuar mbi ankesën e znj. O. D, mbi pengesat në proceduratë regjistrimit në Fakultetin e Shkencave Sociale, sqarojmë se, aplikantja O. D është nxjerrë nga Komisioni si fituese në vendin e shtatë, në listën e fituesve, por, nga ky Komision është bërë një lapsus duke e nxjerrë fituese aplikanten gabimisht, duke mos marrë në konsideratë faktin se ajo nuk plotëson kriteret specifike të nevojshme për të aplikuar dhe për të qenë fituese në këtë Master Shkencor. Menjëherë pas 10 ditësh, në procesin e rishikimit të kriterëve, u konstatua ky fakt dhe u njoftua menjëherë znj. D. Aplikantja në fjalë nuk përmbush kriteret specifike që aplikantët duhet të plotësojnë, të shpallura në web-in e Fakultetit: kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025, sipas Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, Sektori i Sigurimit të Cilësisë.*

Këto kriteret specifike për këtë Master Shkencor janë:

Të zotërojë diplomë bachelor ose të sistemit 4 vjeçar në “Psikologji”, “Ekonomiks” ose “Menaxhim”.

Duke qenë se znj. D zotëron diplomë bachelor në “Punë Sociale”, nuk mundet të vijojë të jetë pjesë e këtij Masteri Shkencor.

Gjithashtu, studentes D iu dhanë disa opsione të tjera në përputhje me diplomën e saj dhe deri tani studentja nuk është përgjigjur pro, ndonjërit prej tyre (procedurë e njohur dhe e aplikuar edhe në raste të tjera të ngjashme).

Në këto rrethana, Komisioni shpall mospërmbushjen e kriterëve me Diplomën dhe e skualifikon si fitueses në këtë program studimi.”

Ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesën nr. 258 regj datë 24.12.2024, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, pasi është skualifikuar nga lista e studentëve fitues, në programin Master Shkencor “Psikologji Organizacionale” për vitin akademik 2024- 2025.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, date 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm/ identifikueshëm⁵”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁶.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁷.

Pra, në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e gjendjes

⁵ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61*

⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim I Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.*

⁷ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019*

arsimore, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si: “...çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Referuar LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislativi në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim

objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore, të pretenduar nga ankuesja si arsyeja ose shkakun për të cilën ajo i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm, duke mos u përjashtuar nga lista e studentëve të shpallur fitues, për të vijuar studimet në programin Master Shkencor “Psikologji Organizacionale” për vitin akademik 2024- 2025.

LMD nuk jep një përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes arsimore. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, se diferencat në trajtim që bazohen në nivelin e arsimit të një personi⁸ ose nivelin e arritjeve në arsim të një personi ose e thënë ndryshe në vlerësimet apo notat e përfituara gjatë ndjekjes së arsimit⁹, do të konsiderohen si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore. Komisioneri vlerëson se, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person i nënshtrohet për shkak të nivelit individual të arsimit, arritjeve të tij në arsim, çertifikatave ose diplomave që një person posedon.

Duke iu rikthyer fakteve, rrethanave dhe pretendimeve për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore të paraqitur nga ankuesja, Komisioneri Konstaton se:

Në nenin 70¹⁰ dhe 76¹¹, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se:

“70/1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS)... 3. Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratohen në senatet e tyre akademike. 4. Programet e studimeve në institucionet e arsimit të

⁸ Shiko: Vendimin nr. 147, datë 26.10.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁹ Shiko: Vendimin nr. 48, datë 19.05.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹⁰ Ciklet dhe programet e studimeve

¹¹ “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”

lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. “

76/1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimi të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë. 2. Pranimi në programet e integruara të studimeve është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të këtij ligji. 3. Kriteret e pranimi të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njëria bazë ofruese e programit. Kriteret bëhen publike nga njëria kryesore dhe QSHA-ja dhe miratohen sipas përcaktimeve në statutin e IAL-së.”

Referuar kriterëve specifike, të shpallura në web-in e Fakultetit të Shkencave Sociale, për aplikantët student që duan të vijnë studimet për Master Shkencor në “Psikologji Organizacionale”, rezulton se janë të shpallura kriteret e mëposhtme:

“Të zotërojë diplomë bachelor ose të sistemit 4 vjeçar në “Psikologji”, “Ekonomiks” ose “Menaxhim”.”

Referuar listës së miratuar nga Komisioni për Vlerësimin e aplikantëve, rezulton se, në listën e studentëve aplikantë prej 25 fituesish, përveç ankueses¹² (që zotëron diplomë bachelor në “Punë Sociale”) dhe studentit me numër identiteti K21103038C¹³, (i cili zotëron diplomë bachelor në “Gazetari”, fakt i njohur dhe pranuar nga vetë ankuesja), të gjithë aplikantët e tjerë të shpallur fitues zotëronin diplomë bachelor në “Psikologji”, në përputhje me kriteret specifike, sipas “Kriterëve të pranimi për vitin 2025-2026”, të përcaktuara nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, pranë UT-së, shpallur në faqen e ëeb-it zyrtar të FSHS-së.

Të dy aplikantët e mësipërm, pavarësisht faktit se ishin kualifikuar *gabimisht dhe në shkelje të kriterëve specifike*, si më sipër, nga ana e Komisionit, janë njoftuar lidhur me këtë fakt dhe të dyve iu është kërkuar që në kushtet kur nuk mund të vijnë pjesë e këtij Masteri Shkencor, të zgjedhin opsione të tjera të ofruara nga Komisioni, në përputhje me diplomat e tyre respektive. Ky fakt është pranuar nga vetë subjekti ankues, duke pohuar që në ndryshim nga studenti tjetër në fjalë, ajo nuk ka pranuar të ndryshojë Masterin Shkencor në një degë tjetër, pasi gabimi është i tyre dhe jo i asaj personalisht.

Pra, rezulton se, si ankuesja, ashtu dhe kandidati tjetër i shpallur fitues, gabimisht nga ana e Komisionit të Vlerësimit, zotërojnë diploma të nivelit bachelor, të ndryshme nga ajo që është e shpallur në kriteret specifike për këtë Master Shkencor, që është e detyrueshme të jetë në: *“Psikologji”, “Ekonomiks” ose “Menaxhim”*. Nga këqyrja që i bëhet listës së 25 fituesve, rezulton se, që të gjithë aplikantët e shpallur fitues të këtij Masteri Shkencor, zotërojnë diplomë bachelor në *“Psikologji”*.

¹² Shpallur e shtata në listën prej 25 fituesish.

¹³ Shpallur i 22-ti, në listën prej 25 fituesish.

Në këtë kuptim, rezulton që diferenca në trajtim dhe trajtimi më pak i favorshëm, i pretenduar nga ankuesja, për shkak të skualifikimit të saj nga lista fillestare e studentëve fitues që ndjekin studimet e ciklit të dytë për Master Shkencor në “Psikologji Organizacionale” për vitin akademik 2025-2026, ka ardhur pikërisht për shkak të mosplotësimit të kriterëve specifike të vendosura¹⁴ (dhe të shpallura publikisht në web-in zyrtar të FSHS) nga njësia përgjegjëse FSH, e cila sipas ligjit ka autoritetin e kompetencën për përcaktimin e kriterëve të pranimit për kandidatët e ciklit të dytë të studimeve, dhe me të cilat ankuesja ka qenë e njohur paraprakisht, që në shpalljen e tyre në ëeb-in e FSHS.

Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se, faktet dhe rrethanat e parashtruara nga ankuesja, ngrenë pretendime për diferencë në trajtim që kanë në bazë gjendjen arsimore të ankuseses, pra, diplomën bachelor të saj, kjo diferencë është e përligjur pikërisht në kriteret specifike të vendosura nga njësia bazë ofruese e programit, e cila ka kompetencën e tagrin për vendosjen e tyre, sipas nenit 76, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë nuk vlerësohet që nga ana e FSHS, të jenë shkelur dispozitat e LMD-së, pavarësisht faktit se, vlerësimi i gabuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit, ka sjellë pasojat për vijimin e rregullt të studimeve për ankuesen, në ciklin e dytë, për Master Shkencor në “Psikologji Organizacionale” për vitin akademik 2025- 2026.

Lidhur me pretendimet për pasojat apo dëmin moral, emocional dhe ekzistencial që ankuesja mund të pretendojë se i është shkaktuar nga skualifikimi nga lista fillestare e studentëve fitues që ndjekin studimet e ciklit të dytë për Master Shkencor në “Psikologji Organizacionale” për vitin akademik 2025- 2026, nga ana e FSHS, ardhur për shkak të gabimit të tyre, Komisioneri vëren se ajo mund ta kërkojë gjyqësisht.

Lidhur me pretendimin e ankuseses, se kërkesave të saj nuk i janë kthyer përgjigje zyrtare nga ana e subjekteve përkatëse (FSHS, Dekani, Rektori i UT-së, etj), Komisioneri vlerëson se, autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në nenin 24¹⁵, të këtij Ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

¹⁴ Pasi ankuesja kriteret e përgjithshme i plotëson.

¹⁵ “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit

E drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, është objekt i rregullimit ligjor të parashkuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Pika 3 e nenit 3, të këtij ligji, sanksionon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”.

Po ashtu, pika 2, e nenit 2, të tij, përcakton se: “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. E drejta e informimit u krijon akses qytetarëve në dokumente zyrtarë dhe ndihmon personat, interesat e të cilëve preken nga vendimmarrje të mundshme administrative, duke u njohur me vendimmarrjet por edhe me procedurën e ankimit. Institucionet publike kanë detyrimin të jenë pro-aktiv në informimin e qytetarëve dhe të aktorëve të interesit.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si Institucioni dhe organi kompetent i krijuar me ligj të posaçëm.

Ankimi bëhet në rastet kur subjekti juridik, institucioni:

- refuzon dhënien e informacionit;
- nuk përgjigjet;
- kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar;
- kthen përgjigje të paplotë.

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashkuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashkuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’u drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashkuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në këtë Ligj, dhe mosrespektimi i dispozitave të tij nga cilido subjekt juridik, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18 të këtij Ligji.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, në analizë të sa më sipër, si dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga znj. O. D, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk plotëson kriteret e kërkuara ligjore për t’iu nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32/1/a, nenin 33, pika 4, shkronja “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës Nr. 258 regj., datë 24.12.2024, të paraqitur nga znj. O. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA